



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 349, Datë 28.12.2022

MBI

**LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALB ENERGY TRADE” SH.P.K. NË VEPRIMTARINË
E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “e”, nenit 5, pika 1, gërma “e” dhe nenit 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2116/7 prot., datë 23.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 283, datë 07.11.2022 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 09.11.2022 dhe 10.11.2022), si dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 18.11.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 1770/6 prot., datë 14.11.2022 dhe nr. 1840/4 prot., datë 17.11.2022, datë 06.12.2022, shoqëria ka depozituar në ERE dokumentacion plotësues të aplikimit.

- Pas shqyrtimit në mbledhjen e bordit të datës 30.11.2022, të relacionit nr. 1999/4 prot., datë 24.11.2022, të përgatitur ng Drejtoria e Licencimeve, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, nga Bordi u la detyrë që të sqarohet me shoqërinë e të dokumentohet se shoqëria disponon në fondet e saj vlerën përkatëse financiare, sipas parashikimeve të planit të biznesit.
- ERE, me shkresën nr. 1840/6 prot., datë 01.12.2022, i kërkoi shoqërisë të depozitojë sa më sipër cituar. Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 1840/7 prot., datë 06.12.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e kërkuar.
- Me vendimin nr. 316, datë 09.12.2022, bordi i ERE-s vendosi të zgjasë me 20 (njëzetë) ditë vendimmarrjen e tij mbi aplikimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k. duke i lënë shoqërisë detyrimin që brenda 10 (dhjetë) ditëve të depozitojë në ERE sqarimet përkatëse në lidhje me dokumentacionin/mbështetjen financiare që vendos në dispozicion të ushtrimit të veprimitarisë së tregtimit të energjisë elektrike.
- ERE njoftoi shoqërinë për vendimmarrjen e mësipërme me shkresën nr. 1840/8 prot., datë 15.12.2022. Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1840/9 prot., datë 20.12.2022, dhe e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 1840/10 prot., datë 22.12.2022, ka depozituar dokumentacionin e kërkuar.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); Shtojcën 1 dhe Shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (Aneksi A).
- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Alb Energy Trade” sh.p.k. ka plotësuar të gjithë dokumentacionin në zbatim të rregullores së licencimit.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Alb Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI